



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 806/4 prot.

Tiranë, më 13. 11. 2019

V E N D I M

Nr. 165, Datë 13. 11. 2019

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 56 Regj., datë 27.05.2019, e shtetases E. D., kundër Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Durrës, me pretendimin diskriminim për shkak të “vendbanimit dhe për shkak të gjendjes shoqërore¹ (si e dënuar)²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesja sqaron se nga muaji Shkurt 2017, deri më datë 10.04.2019, ka vuajtur dënimin me burg pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Ali Demi”, Tiranë (në vijim IEVP). Gjatë kësaj periudhe, fillimisht ankuesja është vënë në dijeni nga ana e personelit të IEVP-së, se nga banesa e saj janë vjedhur të gjitha orenditë, si dhe dyer e dritare. Më datë 10.04.2019, kohë kur ankuesja ka dalë nga IEVP, është vënë në dijeni se banesa e saj është prishur nga strukturat e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Durrës (në vijim IMT Durrës), pa e njoftuar për asnjë nga veprimet e kryera.

Sipas ankueses, në ndërtesën e sipërcituar, ajo ka rreth 25 vite që banon dhe paguan detyrimet e energjisë elektike apo ujë të pijshëm. Veprimet e IMT-së Durrës, janë kryer në mënyrë të qëllimshme në periudhën që ajo ka qënë duke vuajtur dënimin, pasi gjatë të gjithë periudhës që ajo ka jetuar në atë pronë, nuk është njoftuar asnjëherë nga ana e institucioneve apo IMT-së

¹ Referuar Vendimit të KMD-së Nr. 100, datë, 05.04.2018, të qëniti i dënuar është njohur si shkak gjendje sociale.

² Pasi vuante dënimin në IEVP “Ali Demi”, Tiranë.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD;

Durrës, për prishjen e saj. Mbështetur në dokumentacionin bashkëngjitur ankesës, E. D. provon faktin që banesa e saj është në proces legalizimi që prej vitit 2005 dhe ka ndjekur procedurat në vijimësi në vitet në vazhdim. Referuar informacionit të dhënë në ankesë, pavarësisht faktit që pronarët e truallit (G. B. dhe S. B.), kanë në pronësi rreth 2200 metër tokë-truall (përfshirë edhe banesën e saj, ku janë rreth 900 metër tokë dhe 200 metër ndërtim), IMT Durrës, nuk ka nisur procedurën e prishjes së ndërtimeve pa leje për asnjë nga banesat e tjera kufitare që rrethojnë banesën e saj, apo që janë ndërtuar pa leje në truallin në fjalë. Në këtë kuadër, sipas ankueses, ky trajtim i diferencuar ka ardhur vetëm për shkak se ankuesja ka qënë duke vuajtur dënimin me burg, pasi të gjithë ndërtimet e tjera që janë kryer pa leje në truallin e sipërcituar, janë në proces legalizimi dhe ndaj tyre nuk është marrë asnjë masë.

Në përfundim, ankuesja pretendon se trajtimi i saj në mënyrë të pafavorshme dhe diskriminuese nga ana e IMT-së Durrës, është bërë për shkak se ajo ka qënë në pamundësi për të marrë informacion, pasi vuante dënimin në IEVP “Ali Demi”, Tiranë. Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të diskriminimin në veprimet e kryera nga ana e IMT Durrës dhe rikthimin e banesës së saj.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

⁴ Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me anë të shkresës Nr. 806/1 prot., datë 10.06.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa, ku i ka kërkuar informacion⁵ lidhur me pretendimet për diskriminim, të subjektit ankues.
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, IMT Durrës me anë të shkresës⁶ Nr. 1285/2 prot., datë 17.06.2019, vuri në dispozicion të KMD-së informacion lidhur me pretendimet e palës ankuese, duke sqaruar ndër të tjera se: “...në bazë të ankesës së Znj. E. B. (K)⁷, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 993, datë 31.05.2018, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Durrës, ka bërë njoftim për sjellje dokumentacioni Nr. 993/1 prot., datë 30.07.2018, referuar ankesës së znj. E. B., ka nisur procedurën ligjore për kundravajtje: Objekt 1 kat pa leje ndërtimi.”

Në përfundim të përgjigjes, IMT Durrës vuri në dispozicion të KMD-së një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, vetëm procedurën për prishjen e ndërtimit të E. D..

2. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Me shkresën Nr. 806/3 prot., datë 05.08.2019, njoftoi⁸ zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 13.08.2019.

Në seancë ishte e pranishme vetëm pala ndaj së cilës ishte paraqitur ankesa, IMT Durrës, përfaqësuar nga K. L., me detyrë Inspektor pranë këtij institucioni, ndërsa pala ankuese nuk ishte prezent në seancë.

⁵ - Informacion mbi pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e shtetases E. D.

- Kopje të procedurës së ndjekur nga ana e IMT-së Durrës, për prishjen e banesës së shtetases E. D.
- Informacion nëse janë prishur banesa të tjera në zonën ku banon ankuesja dhe në truallin në pronësi të shtetasve G. Bushati dhe S. Bushati. Nëse po kopje të procedurës së prishjes së këtyre objekteve.
- Informacion dhe kopje e akteve, nëse ka ndërtesa të tjera në proces legalizimi në truallin e shtetasve G. B. dhe S. B. Nëse po, a janë marrë masa nga ana e IMT-së Durrës për të nisur procedurat për prishjen e këtyre ndërtimeve.

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 806/2 prot., datë 19.06.2019

⁷ Kjo shtetase ka dorëzuar çertifikatën për vërtetimin e pronësisë, ku rezulton të jetë pëfaqësuese me Prokurë të Posaçme e shtetasve G. B. dhe S. B., të cilët janë pronarë të truallit prej 2212 m², ku ka ndërtuar ankuesja.

⁸ Në shkresën e sipërcituar, u kërkuar nga IMT Bashkia Durrës, të vërë në dispozicion të KMD-së:

- Informacion nëse janë prishur banesa të tjera në zonën ku banon ankuesja dhe në truallin në pronësi të shtetasve G. B. dhe S. B. Nëse po, kopje të procedurës së ndjekur për prishjen e këtyre objekteve.
- Informacion dhe kopje e akteve, nëse ka ndërtesa të tjera në proces legalizimi në truallin e shtetasve G. B. dhe S. B. Nëse po, a janë marrë masa nga ana e IMT-së Durrës për të nisur procedurat për prishjen e këtyre ndërtimeve.

Gjatë seancës dëgjimore, fillimisht K. L. informoi KMD-në se procedura e ndjekur për prishjen e banesës së ankueses, është standarde, siç veprojnë për çdo rast tjetër. Në mbështetje të pretendimeve të tyre nga ana e IMT Durrës, u vunë në dispozicion edhe një herë e gjithë procedura e ndjekur për prishjen e banesës së ankueses, por nuk u vu në dispozicion informacioni i kërkuar nga Komisioneri në shkresat Nr. 806/1 prot., datë 10.06.2019 dhe Nr. 806/3 prot., datë 05.08.2019.

Në përfundim të seancës dëgjimore, nga ana e IMT Durrës u sqarua se brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga momenti i realizimit të seancës dëgjimore do të dërgohet pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i gjithë dokumentacioni dhe informacioni i kërkuar në shkresat Nr. 806/1 prot., datë 10.06.2019 dhe Nr. 806/3 prot., datë 05.08.2019.

Pavarësisht faktit se nga ana e përfaqësuesit të IMT Bashkia Durrës u theksua fakti se do të dërgohet i gjithë dokumentacioni dhe informacioni i kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vijim nuk u vu në dispozicion të KMD-së asnjë përgjigje zyrtare.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Nga kqyrja e dokumentacionit dhe informacioni të depozituar pranë KMD-së, rezulton se, ankuesja në vitin 1994, ka ndërtuar një shtëpi banimi një katëshe me sipërfaqe ndërtimi rreth 80 m², mbi një truall me sipërfaqe 450 m². Më datë 24.03.2005, është paraqitur pranë Bashkisë Durrës dhe ka kryer Vetëdeklarim Nr. 7413 prot., për legalizimin e kësaj ndërtese, duke kryer pagesën e detyrimeve për shërbimin e legalizimit. Në kufi me pronën e ankueses, më datë 23.03.2005, F. Z. ka bërë Vetëdeklarim për Legalizim Nr. 7414 prot., të dy ndërtesave të banimit me sipërfaqe 120 m² e ndërtuar mbi një truall me sipërfaqe 450 m². Lidhur me këtë deklarim Këshilli i Ministrave me Vendim Nr. 490, datë 18.06.2013 *“Për kalimin e pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”*, ka miratuar kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore në favor të poseduesit, shtetasit F. Z. Me anë të Deklaratës Noteriale Nr. 185 Rep., Nr. 859/2 Kol., datë 22.01.2016, shtetasi F. Z. ka deklaruar se është dakord që procedura për legalizimin dhe rregjistrimin e këtij ndërtimi të vazhdojë në emër të ankueses dhe se heq dorë nga çdo pretendim në të ardhmen mbi këtë pronë.

Referuar akteve të vëna në dispozicion, së pari dokumentit⁹ të lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, E. D. ka lidhur kontratë të Energjisë Elektrike dhe paguan energjinë e konsumuar që prej muajin Dhjetor të vitit 2007. Ndërsa referuar Vërtetimit Nr. 837 prot., datë 02.05.2019, të lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a., konstatohet se është abonente prej muajit Mars 2010 deri në Maj 2019.

⁹ Datë 03.05.2019

Mbështetur në provat e administruara, në fillimin e vitit 2017, në ambjentet e banesës së saj, ankuesja ka lëshuar një pjesë të banesës, për të strehuar shtetasin D. K. Më datë 03.02.2017, pas kontrollit të ushtruar nga ana e strukturave të policisë së shtetit në banesë, ankuesja është arrestuar si e dyshuar për veprën penale të “Prodhimin dhe shitjes së narkotikëve”. Nga muaji Shkurt 2017, deri më datë 10.04.2019, ka vuajtur dënimin me burg pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Ali Demi”, Tiranë (në vijim IEVP).

Ndërkohë që ankuesja vuante dënimin me burg, shtetasi D. K., më datë 06.04.2017 është paraqitur pranë Stacionit të Policisë së Plazhit Durrës, ku ka deklaruar se ka vjedhur banesën e ankueses. Në këto kushte, nga ana e Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, janë kryer veprimet hetimore dhe në përfundim shtetasi D. K. është dënuar me burg për veprën penale të vjedhjes.

Gjatë kohës që ka qënë duke vuajtur dënimin me burg, është vënë në dijeni nga ana e personelit të IEVP-së, se nga banesa e saj janë vjedhur të gjitha orënditë, si dhe dyer e dritare. Më datë 10.04.2019, kohë kur ankuesja ka dalë nga IEVP, ka konstatuar se banesa e saj ishte prishur dhe është vënë në dijeni se këto veprime janë kryer nga strukturat e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Durrës.

Pasi ankuesja ka konstatuar prishjen e ndëtimeve të saj, i është drejtuar IMT-së Durrës, duke kërkuar informacionin përkatës. Në përgjigje të kërkesës së paraqitur nga ankuesja, IMT Durrës ka vënë në dispozicion¹⁰ të gjithë dokumentacionin dhe praktikën e ndjekur për prishjen e tre banesave të saj.

Nga analizimi i praktikave të sipërcituara, konstatohet se mbështetur në ankesën¹¹ e paraqitur nga shtetësja E. B. (e cila referuar dokumentacionit të administruar rezulton të jetë përfaqësuesja e pronarëve, shtetasve G. B. dhe S. B., të truallit ku ka ndërtuar ankuesja), IMT Durrës ka hartuar dhe dërguar shkresën Nr. 993/1 prot., datë 30.07.2018, në adresën Lagja 13, Plazh, Durrës, me anë të së cilës ka kërkuar nga subjekti të cilit i drejtohet, kopje të dokumentacionit tekniko-ligjor për objektin. Në këtë shkresë konstatohet se nuk ka një subjekt ndaj të cilit i drejtohet, një numër të banesës apo adresë të saktë të saj. Nga ana e strukturave të IMT Durrës, më datë 20.08.2018, është kryer inspektim pranë banesave të ankueses, ku janë mbajtur tre procesverbale¹² për secilën prej tyre, të cilat së bashku me shkresën Nr. 993/1 prot., datë 30.07.2018, janë afishuar në ndërtesat përkatëse. Më pas, për secilin ndërtim janë hartuar Relacionet¹³ përkatëse drejtuar Kryeinspektorit të IMT-së Durrës, në të cilat evidentohet se është konstatuar: 1 objekt në fazë ndërtimore të përfunduar 1 kat, me murë tulle, pa çati, pa dyer, pa dritare dhe pa leje ndërtimi; 1 objekt në fazë ndërtimore të përfunduar 1 kat, me murë tulle, çati me tjegulla, pa dyer, pa dritare dhe pa leje ndërtimi dhe 1 objekt në fazë ndërtimore të përfunduar 1 kat, me murë me blloqe

¹⁰ Me anë të shkresës Nr. 853/1 prot., datë 23.04.2019

¹¹ Protokolluar pranë Bashkisë Durrës me Nr. 993 prot., datë 31.05.2018

¹² Nr. 18, Nr. 19 dhe Nr. 20, datë 20.08.2018, të cilat janë të administruara në dosje.

¹³ Nr. 1624 prot., datë 22.08.2018; Nr. 1625 prot., datë 22.08.2018 dhe Nr. 1626 prot., datë 22.02.2018

betoni, pa çati, pa dyer, pa dritare dhe pa leje ndërtimi. Në vijim të procedurave të ndjekura nga ana e IMT Durrës për secilën nga banesat janë marrë vendimet:

- Vendim “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm” Nr. 19, datë 27.08.2018
- Vendim “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm” Nr. 20, datë 27.08.2018
- Vendim “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm” Nr. 21, datë 27.08.2018

Referuar vendimeve të sipërcituara, evidentohet se kundërvajtësi është i paidentifikuar. Më pas IMT Durrës ka afishuar në secilin objekt vendimin për prishjen e tyre, si dhe ka kërkuar afishimin e këtyre vendimeve edhe në Sektorin e Informacionit të Njesisë Administrative Nr. 5 Durrës. Gjithashtu, i është drejtuar me anë të kërkesës për mbështetje në ekzekutimin e prishjes së këtyre ndërtimeve, Komisarariatit të Policisë Durrës, Policisë Bashkiake Durrës, Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës dhe Njesisë Administrative Nr. 5 Durrës.

Në vijim, nga ana e IMT-së Durrës, më datë 18.09.2018, është bërë ekzekutimi i vendimeve të sipërcituara dhe prishja e ndërtimeve të ankueses.

Neni 12, i Ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, të ndryshuar, ndër të tjera parashikon se: “...4. Subjekti që kontrollohet (sipas rastit, investitori, zhvilluesi, ndërtuesi, projektuesi, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi, kolaudatori, prodhuesi i materialeve të ndërtimit etj.) dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e punimit/ndërtimit janë të detyruar të lejojnë kryerjen e kontrollit, të vënë në dispozicion të grupit të kontrollit të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga aktet normative në fuqi, si dhe të ndihmojnë në shqyrtimin e tij.

5. Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës të konstatimit dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar ose përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar.

6. Kur subjekti i kontrolluar nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin ose nuk është i pranishëm, ky fakt pasqyrohet në procesverbal dhe nënshkruhet nga grupi i inspektimit. Kur subjekti nuk është i pranishëm, i jepet një kopje e procesverbalit brenda 5 ditëve nga data e kontrollit.

7. Nëse identiteti dhe adresa e subjektit të kontrolluar nuk dihen, një kopje e procesverbalit të konstatimit afishohet për 5 ditë në vendpublikimet e njësisë vendore përkatëse dhe në kantierin e ndërtimit. Me kalimin e këtij afati, vlerësohet se subjekti i kontrolluar është njoftuar për rezultatin e kontrollit.

Në analizë të parashikimeve të sipërcituara, strukturat e IMT-së Durrës, ndjekin këtë praktikë dhe hapat e parashikuara në Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, në momentin që ndërtimet pa leje janë ndërtuar pas

datës 27.06.2014 ose në proces ndërtimi. Pasi për të gjithë ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më datë 27.06.2014, zbatohet Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, i ndryshuar.

Në Nenin 2, të Ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, të ndryshuar, parashikohet se: “1. Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj... 4. Të gjitha ndërtimet e tjera pa leje, të cilat nuk u përgjigjen kushteve të përcaktuara në pikat 1 dhe 3 të këtij neni, trajtohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit, të ndryshuar.”

Mbështetur në parashikimin ligjor të sipërcituar, konstatohet se ndërtimet e ankueses nuk preken dhe nuk bëjnë pjesë në objektin apo fushën e veprimit të Ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, por të Ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, i ndryshuar. Referuar provave dhe fakteve të vëna në dispozicion nga ana e palëve në proces, për këto ndërtime ankuesja kishte dorëzuar dhe kishte bërë aplikimin përkatës për legalizimin e tyre. Gjithashtu, fakti që ankuesja ka aplikuar dhe dorëzuar pranë Bashkisë Durrës dhe ALUIZNI-t, të gjithë dokumentacionin e kërkuar, si dhe pagesat përkatëse nga viti 2005 e në vijim, për legalizimin e ndërtimeve të saj, provon edhe një herë se ndërtimet e saj janë objekt i Ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”.

Në nenin 5 të ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, të ndryshuar, ku parashikohen **detyrat e njësisë së qeverisjes vendore**, përcaktohet se: “ Sipas këtij ligji, **njësia e qeverisjes vendore ka këto detyra:**

a) ngre strukturat e nevojshme për pranimin, trajtimin dhe kontrollin e vetëdeklarimeve të objekteve pa leje, si dhe për zbatimin e detyrave të përcaktuara në këtë ligj, për kryerjen e procesit të legalizimit...

b) identifikon në terren ndërtimet pa leje, për të cilat nuk është bërë vetëdeklarimi, identifikon të gjitha rastet eventuale të ndërtimeve pa leje, të kryera pas miratimit të këtij ligji dhe nis procedurat për prishjen e tyre, sipas ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit””.

Neni 4 i Ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, parashikon përgjegjësitë e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, ku ndër të tjera citohet se: “Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i

mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse. Për përmbushjen e përgjegjësi të parashikuara me ligj, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore mbështetet nga policia e njësisë vendore dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore.”

Pavarësisht se ka kërkuar nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Durrës mbështetjen e tyre në procesin e prishjes së ndërtimeve të ankueses, IMT Durrës nuk ka marrë asnjë masë për verifikimin e rastit apo të ndërtimeve të ankueses, nëse janë në proces legalizimi apo janë ndërtime *pa leje të ndërtuara pas datës 27.6.2014*, siç parashikohet në ligjin Nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje*”, të ndryshuar.

Përsa më lartë dhe lidhur me procedurën e ndjekur nga ana e IMT-së Durrës, në raste të ngjashme me atë të ankueses, Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi i kërkoi këtij të fundit:

- vënien në dispozicion të provave dhe fakteve lidhur me masat e marra për banesa të tjera në zonën ku banon ankuesja dhe në truallin në pronësi të shtetasve G. B. dhe S. B. Nëse po, kopje të procedurës së ndjekur për prishjen së këtyre objekteve.
- Informacion dhe kopje e akteve, nëse ka ndërtesa të tjera në proces legalizimi në truallin e shtetasve G. B. dhe S. B. Nëse po, a janë marrë masa nga ana e IMT-së Durrës për të nisur procedurat për prishjen e këtyre ndërtimeve.

Pavarësisht kërkesave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me procedurën e ndjekur nga ana e IMT-së Durrës, në raste të ngjashme me atë të ankueses, nga ana e tyre nuk u vu asnjë informacion në dispozicion, si dhe nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin faktin se ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të diferencuar dhe të padrejtë.

B. Shkaku i mbrojtur

Mbështetur në nenin 2¹⁴ të ligjit Nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që

¹⁴ Neni 2: “*Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.*”

perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me standartin ligjor, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e IMT-së Durrës për shkak të *vendbanimit dhe gjendjes shoqërore*¹⁵. Përsa i përket pretendimit fillestar të diskriminimit për “*çdo shkak tjetër*”, ankuesja e lidh këtë pretendim me faktin se në periudhën që IMT Durrës ka zhvilluar procedurat e prishjes së banesës së saj, ajo ka qënë në pamundësi për të marrë informacion, pasi vuante dënimin në IEVP “Ali Demi”, Tiranë.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹⁶. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh¹⁷.

Në mungesë të një praktike kombëtare Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. **Bazuar në provat e administruara, pretendimi i ankueses se shkak për diskriminimin e saj është bërë gjendja shoqërore, si e dënuar me burg rezulton të jetë i provuar.**

¹⁵ Se ajo ka qënë në pamundësi për të marrë informacion, pasi vuante dënimin në IEVP “Ali Demi”, Tiranë

¹⁶ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

¹⁷ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e IMT Durrës, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të padrejtë apo të pafavorshëm të ankuesit.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se, E. D. i është nënshtruar një qëndrimi të padrejtë nga ana e IMT-së Durrës.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës e ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri kishte për synim të siguronte informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës lidhur me rastin e E. D., në mënyrë që të mund të dilte në konkluzione të qarta dhe objektive lidhur me pretendimin e saj për trajtim të pabarabartë dhe të disfavorshëm nga ana e IMT-së Durrës.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast IMT Durrës. Pra, në këtë rast IMT Durrës duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshme, për shkaqet e pretenduara nga subjekti ankues.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Bazuar në nenin 32, pika 2: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke dhënë informacionin që i nevojitet atij”*.

Në mungesë të provave dhe fakteve nga ana e IMT-së Durrës, si pala e cila bazuar në legjislacionin në fuqi ka barrën e provës për të vërtetuar që nuk kemi të bëjmë me sjellje diskriminuese, Komisioneri në vendimin e tij është mbështetur në informacionin e sjellë nga subjekti ankues.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës garanton barazinë *“në gëzimin e të drejtave dhe lirive”* të përcaktuara në të. Protokoli 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹⁸

Standardet e Këshillit të Evropës bazohen në nenin 14 të KEDNJ, *“ndalimi i diskriminimit”*, në përmbajtjen e të cilit parashikohet se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”*. Siç mund të konstatohet, në këtë nen mbrojtja nga diskriminimi gjen zbatim në lidhje me ato të drejta dhe liri themelore të parashikuara në Konventë dhe në Protokollet e saj shtesë.

¹⁸ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_law_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 20, parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi... 4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Referuar provave dhe legjislacionit të vënë në dispozicion, në rastin konkret nga ana e Bashkisë Durrës, duhet të ishin marrë masa për identifikimin në terren të ndërtimeve të ankueses, si dhe të ndërtimeve të tjera pa leje, për të cilat nuk është bërë vetëdeklarim dhe identifikimin e ndërtimeve të kryera rishtas, pas miratimit të Ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, i ndryshuar. Pas marrjes së këtij informacioni, njësitë e qeverisjes vendore ose në rastin konkret Bashkia Durrës, duhet të nis procedurat për prishjen e ndërtimeve pa leje të ndërtuara pas datës 27.06.2014, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar.

Pavarësisht se ka kërkuar nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Durrës mbështetjen e tyre në procesin e prishjes së ndërtimeve të ankueses, IMT Durrës nuk ka marrë asnjë masë për verifikimin e rastit apo të ndërtimeve të ankueses, nëse janë në proces legalizimi apo janë ndërtime *pa leje të ndërtuara pas datës 27.6.2014*, siç parashikohet në ligjin Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, të ndryshuar.

Gjithashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka mbajtur të njëjtën frymë në Vendimin nr. 113, datë 26.08.2019, ku ka konstatuar diskriminimin e shtetasit V. H. për çdo shkak tjetër.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e IMT-së Durrës nuk u vunë në dispozicion prova dhe fakte për të provuar se veprimet e ndërmarra nga ana e këtij institucioni për prishjen e banesave të ankueses për trajtimin e ankueses në mënyrë të barabartë dhe të favorshme.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se praktika, e ndjekur nga ana e IMT-së Durrës, e ka vënë ankuesen në kushte të pafavorshme, në raport me persona të tjerë të cilët ndodhen në situatë të njëjtë përsa i përket pronës dhe në kushte të ndryshme me të, për shkak të gjendjes së saj shoqërore si e dënuar. Në vijim të arsyetimit, përveç faktit që nga ana e IMT-së Durrës nuk është zbatuar legjislacioni i duhur për prishjen e ndërtimeve të ankueses, gjithashtu nuk është vënë në dispozicion asnjë provë apo fakt se në raste të ngjashme me ankuesen ky institucion ka vepruar në të njëjtën mënyrë.

Në kushtet kur, nga ana e IMT-së Durrës nuk u arrit të provohej që procedura e ndjekur për prishjen e ndërtimeve të ankueses, ndjek një qëllim të ligjshëm, si dhe veprimet e kryera janë të arsyeshme dhe proporcionale, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e IMT-së Durrës, pikërisht për shkakun e pretenduar prej saj, atë të gjendjes shoqërore si e dënuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të E. D., për shkak të gjendjes shoqërore pasi vuante dënimin me burg, nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Durrës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shoqërore)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)